



Nr.Prot. _____

Gjirokastrë, më ___/___/ 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Blerje kablo ABC (TU) me aksesorë”**.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 1321210-7 - Kablo të tensionit të ulët, 31681410-0 - Materiale elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT: 229,807,878 (dyqind e njëzet e nëntë milion e tetëqind e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 2,296,241.79 (dy milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzet e një pikë shtatëdhjetë e nëntë) Euro pa tvsh , shenim: referuar kursit te B.SH date 09.08.2024, 1 euro = 100.08 ALL.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastrë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 (i ndryshuar), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastrë”, ka vendosur që kjo procedure të mos jetë me lote sipas arsytimit të mëposhtëm:

Arsyeja pse është marre vendim në lidhje me mosparashikimin e ndarjes në lote është bërë duke patur parasysh faktin se Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Gjirokastrë po

prokuron në bazë të autorizimit nr.7056 prot, dt.21.06.2024 të OSSH sh.a, **{Blerje kablo ABC (TU) me aksesore}**, e cila ka hartuar plan shpërndarje sipas kërkesave të drejtorive rajonale.



Gjithashtu mos ndarja në lote është më pak e kushtueshme për AK, pasi kjo do të përfshijë vetëm një kontratë. Menaxhimi dhe ofrimi i furnizimeve mund të jenë më të lehta dhe më pak të kushtueshme për sa i takon kohës, burimeve njerezore dhe logjistike.

Kjo procedurë është e pamundur teknikisht të ndahet në lote sepse nga vete objekti i prokurimit kemi të bëjmë me furnizim mallrash dhe aksesori në funksion të tyre, të cilat klasifikohen në të njëjtën kategori të mallrave objekt prokurimi.

Referuar legjislacionit të prokurimit publik, i cili njih gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Në këto kushte, duke qënë se kemi të bëjmë me një familje mallrash të vetme dhe si i tillë nuk pengon operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procedurën objekt prokurimi gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):



Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....
(Shënim: *përcaktimi nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2. 1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43/2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Duke marrë në konsideratë llojin e mallrave dhe koheshtrirjen e kontratës për këtë objekt procedure prokurimi, kerkohet që OE ofertues të deshmojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kerkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim është kërkuar vërtetim i xhiros për tre vitet e fundit në një vlerë jo më e vogël se **100%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet .

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar neni 13 pika 2: "*Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi*".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku



bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore **te maturuara për vitin 2024** (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendren Kombëtare të Bisnesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

Ky kriter të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas Shtojcës Nr. 8 të DST-së. Ndërsa Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetedeklarimit të kryer në Shtojcën Nr. 8 të DST-së

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së



njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 35 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilësi të mallrave të kërkuar në këto objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të këto realizuar me kontrata të ngjashme, të jete afër limitit maksimal dhe në këto mënyrë, AK krijon siguri dhe besueshmëri që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi me sukses dhe pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

2.4.1 Certifikate ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) **per sistemin e menaxhimit të cilësisë, OSE EKUIVALIENTE** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes).



Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomike, secili anetar duhet te paraqese certifikatat ISO te sipercituar **sipas zërave të mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.**

Për certifikatën e cilësisë së prodhuesit **ISO 9001**, në rast se OE ofertues nuk është prodhues duhet te paraqes vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë. AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE kualifikohet i pari, AK ka të drejtën të kërkojë paraqitjen e certifikatës të cilësisë të prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 dhe 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) dhe nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri mbështetet në specifikimet teknike të dërguara nga OSSH sh.a.

2.4.2 Autorizim te prodhuesit / distributorit per cdo artikull te kerkuar (sipas preventivit). Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij. Ne rast te disponimit te autorizimit te prodhuesit ne gjuhe te huaj, ky dokument te paraqitet i perkthyer dhe i noterizuar ne gjuhen zyrtare shqipe. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqese: Katalogun/et ose fragmente te katalogut /eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi (**të përkthyer dhe noterizuar ne gjuhen e kerkuar ne dokumentat tenderi**), ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen. *Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.*



Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. AK ka kërkuar katalogët e mallit që do të ofrohet nga OE për të vërtetuar se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesa për katalogët e produktit ka rëndësi specifike për këtë procedurë prokurim sepse katalogu lehtëson punën e AK për të verifikuar nëse produkti i ofruar nga OE plotëson standartet e përcaktuara nga AK në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.4.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e mallrave të prodhuara (lista e mësipërme e mallrave) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen që të shërbejnë AK-se, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme si aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe çdo element tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, Operatorët Ekonomikë, duhet të paraqesin dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, leshuar nga institucione të autorizuar, ose nga prodhuesi, për mallrat e cituar më sipër, për të krijuar bindjen se malli i ofruar është brenda parametërve të kërkuara. Është në të drejtën e AK të kërkojë dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të vendosura, përpara se AK të bëjë përzgjedhjen e OE-se fituese. Kjo kërkesë është në përputhje me pikën 6/c, të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu vendosja e këtij kriteri mbështetet në specifikimet teknike të dërguara nga OSSH sh.a.

2.4.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim CE.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e deklaratës së konformitetit për produktet që kërkohen më sipër, është një kërkesë e lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës dhe duke qenë se, Autoriteti Kontraktor është përfitues i kontratës objekt prokurimi është në të drejtën e tij të garantohet se OE-të pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilesisë së mallit që do të ofrohet, rrjedhimisht është e drejtë e AK-se të kërkojë ofertuesve që të paraqesin deklaratë për të vërtetuar konformitetin prodhim të produkteve të procedurës së prokurimit. Për Autoritetin Kontraktor është e nevojshme që, Operatorët ekonomikë gjatë ofertimit të tyre të provojnë se zoterojnë kapacitetet teknike lidhur me deklaratën e konformitetit për artikujt e kërkuara më sipër. Kërkesa e mësipërme ka si qëllim të sigurojë AK-ne, mbi aftësitë teknike të OE fitues në drejtim të përmbushjes me sukses të kontratës dhe detyrimeve në zbatim të saj, konform standardeve të mirepërcaktuara në DST.



Ky kriter nuk është diskriminues dhe është proporcional me objektin e kontratës, si dhe është në zbatim të Nenit 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e këtij kriteri mbështetet në specifikimet teknike të dërguara nga OSSH sh.a.

2.4.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikate leshuar nga prodhuesi (ose distributori i autorizuar) që kabllot e ofruar janë në përputhje me standardin e harmonizuar Evropian HD 626-S1, ose ekuivalentin e saj sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit Shqiptar.

Argumentimi: HD 626-S1 zbatohet për kabllot me tension nominal $U_0/U(U_m)=0.6/1(1.2)$ kV të përdorura në sistemet e shpërndarjes së energjisë ajrore kryesisht për shpërndarje publike, me tension maksimal të sistemit që nuk kalon 1.2 kV. Kjo pjesë (Pjesa 1) specifikon kërkesat e përgjithshme të zbatueshme për këto kabllot, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në seksionet e veçanta të kësaj HD.

Vendosja e këtij kriteri mbështetet në specifikimet teknike të dërguara nga OSSH sh.a.

2.4.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë tabelat me të dhënat teknike të kabllave të kërkuara, të plotësuara dhe firmosur nga prodhuesi.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është mbështetur në specifikimet teknike të dërguara nga OSSH sh.a.

2.4.8 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin mostrat e mallrave, në momentin e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale Gjyrokaster OSSH sh.a., perkatesisht:

- Kabëll ABC me vetmbajtje AL 4x95 mm²
- Kabëll AL 4x25 mm², izolacion XLPE 0.6/1kV
- Kabëll koaksial CU-1x6/6mm² (për lidhje të abonentëve 1 fazorë)
- Kapikord tubular bimetalike AL-CU përcjell 35 mm²
- Konektor linje 16-95 mm²
- Tirantues linje për sistem 4x(70-120) mm²
- Kabëll CU 4x10 mm² izolacion XLPE 0.6/1 kV

Argumentimi: Në përputhje me nenin 40 prg.6 a) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 (i ndryshuar), si dhe udhëzimit nr.03 datë 12.04.2022 të APP-së “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik”.



- Në funksion të plotesimit të Shtojcës 8 “Formulari përmbledhës i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emer, Mbiemër, Ateshi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuara të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoret e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuar në parashikimet e Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:

- *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, ateshi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e



mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura pranë OSSH sh.a Qendër. Sa i takon përlogaritjes së fondi limit është përlogaritur nga komisioni i veçantë i ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.